



South East European Network
for Professionalization of Media

GAZETARIA NËN PRESION EKONOMIK, POLITIK DHE DIGJITAL

E ardhmja e medias në Kosovë –
Shqyrtimi i aktorëve kyçë

Jeton Mehmeti

MEDIA JONË:

Një projekt i shoqërisë civile për të nxitur edukimin për median
dhe aktivizmin, kundër polarizimit, në dobi të dialogut



MEDIA JONË:

Një projekt i shoqërisë civile për të nxitur edukimin për median dhe aktivizmin, kundër polarizimit, në dobi të dialogut

GAZETARIA NËN PRESION EKONOMIK, POLITIK DHE DIGJITAL **E ardhmja e medias në Kosovë – Shqyrtimi i aktorëve kyçë**

Autor: Jeton Mehmeti

Drejtuese e kërkimit rajonal: Brankica Petković

Redaktore rajonale e kërkimit: Vesna Nikodinoska

Redaktore gjuhësore: Evliana Berani

Përkthyes: Imer Mushkolaj

Dizajn: Špela Kranjec

Botues:

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

Fondacioni "Mediacentar", Sarajevë

Kosovë, janar 2026



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova



*Botimi u krye me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian.
Përmbytja e tij është përgjegjësia e vetme e autorit dhe botuesve
dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pozicionin e Bashkimit Europian.*

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
I. HYRJE	6
II. MENDIME MBI MEDIAN, GAZETARINË DHE DEMOKRACINË	8
III. REFLEKTIME MBI TRENDET DHE RREZIQET E IDENTIFIKUARA NË FAZËN E PARË TË HULUMTIMIT	11
IV. PËRDORIMI I MEDIAS DHE BESIMI	14
V. NEVOJAT DHE KËRKESAT E QYTETARËVE	17
VI. MENDIME MBI TË ARDHMEN E MEDIAS DHE GAZETARISË	19
VII. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	22
REFERENCAT DHE BURIMET	25
PËR AUTORIN	29

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kjo fazë e dytë e hulumtimit *"E ardhmja e medias në Kosovë"*¹ shqyrton mënyrën se si peizazhi mediatik i vendit përjetohet nga ata që jetojnë dhe punojnë brenda tij, qytetarët, gazetarët dhe profesionistët e medias. Ajo shkon përtej treguesve statistikorë, duke kapur perceptimet mbi lirinë, besimin dhe llogaridhënien në praktikën e përditshme mediatike. Gjetjet tregojnë një sektor mediatik që mbetet formalisht i lirë, por strukturalisht i brishtë, ku varësia ekonomike, retorika politike dhe konkurrenca digjitale vazhdojnë të gërryejnë pavarësinë gazetareske dhe cilësinë e përmbajtjes mediatike. Duke u mbështetur në gjetjet bazë të studimit *"E ardhmja e medias në Kosovë"* (Mehmeti, 2025), studimi thekson se si rënia e besimit, shkeljet etike dhe rritja e armiqësisë politike po riformësojnë si rolin e gazetarisë, ashtu edhe besimin publik ndaj saj. Këto dinamika zhvillohen brenda një shoqërie gjithnjë e më të polarizuar, ku ndarjet politike dhe narrativat konkurruese ndikojnë si në prodhimin e lajmit, ashtu edhe në mënyrën se si qytetarët e interpretojnë atë.

Rënia e besimit publik doli si shqetësimi më urgjent. Të dhënat nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) tregojnë se besimi në media në Kosovë ka rënë nga 50 për qind në vitin 2023 në vetëm 30 për qind në vitin 2024. Dy dinamika të ndërlidhura duket se e nxisin këtë erozion. Së pari, dobësitë e brendshme brenda sektorit mediatik, veçanërisht dështimi për të respektuar standardet profesionale dhe etike, kanë cenuar besueshmërinë. Të dhënat nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) tregojnë se, nga 90 ankesa të shqyrtuara ndërmjet janarit dhe shtatorit 2025, 47 u vërtetuan si shkelje të Kodit të Etikës. Së dyti, presionet e jashtme, veçanërisht nga elitat politike, kanë dëmtuar më tej perceptimin publik për gazetarinë. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dokumentoi disa sulme verbale dhe administrative nga udhëheqës politikë ndërmjet janarit dhe tetorit 2025, përfshirë fushata shpifjeje dhe frikësim të gazetarëve. Kjo retorikë ka normalizuar armiqësinë publike ndaj medias dhe ka krijuar një klimë frike.

Së bashku, këta faktorë të brendshëm dhe të jashtëm forcojnë njëri-tjetrin, duke prodhuar një rënie të qëndrueshme të besueshmërisë së medias dhe besimit qytetar. Këto zhvillime pasqyrojnë modelet më të gjera rajonale të

Gjetjet tregojnë një sektor mediatik që mbetet formalisht i lirë, por strukturalisht i brishtë, ku varësia ekonomike, retorika politike dhe konkurrenca digjitale vazhdojnë të gërryejnë pavarësinë gazetareske dhe cilësinë e përmbajtjes mediatike.

1 Për më shumë mbi fazën e parë të hulumtimit **E ardhmja e medias**, shih: https://futureofmedia.seenpm.org/wp-content/uploads/2025/02/Ourmedia_KS-ENG_25-01-22.pdf

evidentuara në Indeksin e Reporterëve pa Kufij (RSF), i cili e ka ulur Kosovën nga një kontekst “problematik por në përmirësim” në një kontekst “i vështirë dhe në rënie” për lirinë e medias, me rezultate veçanërisht të ulëta në treguesit politikë dhe ekonomikë.

Pavarësisht këtyre sfidave, gjetjet e hulumtimit tregojnë bazat e forta për rinovimin e rolit të medias në shoqëri. Qytetarët dhe profesionistët e medias ndajnë një vizion të qartë për një gazetari më etike, gjithëpërfshirëse dhe me përgjegjësi të përbashkët shoqërore. Të dy grupet theksuan se besimi mund të rindërtohet nëpërmjet raportimit të besueshëm, integritetit profesional dhe llogaridhënies publike. Qytetarët kërkuar përmbajtje që reflekton realitetet e tyre të përditshme, edukim, punësim, zhvillim komunitar dhe jo konflikte të pafundshme politike, ndërsa gazetarët nënvizuan nevojën për financim transparent, vetërregullim më të fortë dhe mbështetje të vazhdueshme të donatorëve për mediat e pavarura. Në të gjitha fokus grupet, pjesëmarrësit ranë dakord se teknologjia dhe inteligjenca artificiale do të riformësojnë gazetarinë, por insistuan që mbikëqyrja njerëzore, empatia dhe etika të mbeten në thelbin e saj.

I.

HYRJE

Ky raport përbën fazën e dytë të projektit hulumtues “E ardhmja e medias”. Gjetjet e fazës së parë u publikuan në një raport në janar 2025 me titullin “Peizazhi në zgjerim i medias, rënia e sigurisë së gazetarëve dhe niveli i ulët i edukimit medial; E ardhmja e medias në Kosovë: Fakte dhe tendenca” (Mehmeti, 2025). Bazuar ekskluzivisht në të dhëna sasiore, faza e parë ofroi një pasqyrë përshkruese dhe analitike të një seti të gjerë të dhënash mbi treguesit e medias dhe demokracisë. Duke shqyrtuar variabla të lidhura me gazetarinë, përdorimin e medias, besimin dhe qeverisjen, studimi synonte të vendoste një kuptim të bazuar në prova mbi dinamikat strukturore që formësojnë sistemin mediatik të Kosovës. Të dhënat u organizuan në pesë fusha tematike, të dhëna të përgjithshme mbi popullsinë dhe ekonominë e Kosovës, gazetaria dhe arsimi, struktura e medias, përdorimi i medias dhe besimi, si dhe tregues të demokracisë, sundimit të ligjit dhe korrupsionit, çështje këto të përmbledhura nga burime primare dhe sekondare.

Arsyeja për të kryer këtë fazë të dytë është të shkohet përtej analizës sasiore dhe institucionale të fazës së parë dhe të kapen përvojat dhe perceptimet e qytetarëve dhe profesionistëve të medias. Nëpërmjet diskutimeve në fokus grupe, kjo fazë synon të kuptojë se si njerëzit interpretojnë transformimet e vazhdueshme në media dhe demokraci, si i përjetojnë ndryshimet në ekosistemet e informacionit dhe si e konceptojnë rolin e ardhshëm të gazetarisë dhe medias në shoqëri.

Diskutimi u përqendrua kryesisht rreth trendeve kryesore që u identifikuan gjatë fazës së parë. Trendi i parë i dukshëm është rënia e besimit të qytetarëve ndaj medias. Ndërsa televizioni mbetet burimi më i besueshëm i informacionit, kredibiliteti i tij është dobësuar te audiencat më të reja, të cilat gjithnjë e më shumë mbështeten te platformat sociale për lajme. Shkëputja e kufijve ndërmjet gazetarisë, komentit dhe mesazheve politike ka thelluar më tej skepticizmin ndaj medias në tërësi. Një sfidë e qëndrueshme e dytë lidhet me presionet politike dhe ekonomike, pasi gazetarët vazhdojnë të përballen me sulme dhe kërcënime që minojnë sigurinë dhe pavarësinë e tyre, një sfidë që mund të nxisë vetëcensurë në afat të gjatë. Së fundi, dixhitalizimi i shpejtë i peizazhit mediatik ka rritur qasjen në informacion dhe ka stimuluar inovacionin por, gjithashtu, ka fragmentuar audiencat dhe ka intensifikuar konkurrencën ndërmjet mediave dhe influencësve. Konkurrenca, gjithashtu, po shtyn shumë media t'i japin prioritet shpejtësisë mbi saktësinë dhe verifikimin, që po shpie median drejt shkeljes së standardeve të gazetarisë.

Shkëputja e kufijve ndërmjet gazetarisë, komentit dhe mesazheve politike ka thelluar më tej skepticizmin ndaj medias në tërësi.

Faza e dytë synon të thellojë kuptimin e ndërvarësive ndërmjet medias dhe demokracisë nëpërmjet zërave të atyre që konsumojnë dhe prodhojnë informacion. Konkretisht, ajo synon të kuptojë: si lidhen perceptimet e qytetarëve me trendet e identifikuara në fazën e parë? Si i perceptojnë qytetarët dhe gazetarët rolin aktual të medias në demokraci? Cilat janë pritshmëritë e tyre për të ardhmen e saj? Çfarë masash mund të forcojnë dhe ruajnë funksionet demokratike të medias në Kosovë?

Hulumtimi për fazën e dytë u krye nëpërmjet tre fokus grupeve me 28 pjesëmarrës (14 gra dhe 14 burra), të dizajnuara për të siguruar diversitet në moshë, gjini, gjeografi dhe sfond profesional.

- Dy fokus grupe me qytetarë, një me pjesëmarrës të rinj (mosha 18–35) e zhvilluar më 5 qershor 2025 në Prishtinë dhe një me pjesëmarrës më të moshuar (mosha 36–65) e zhvilluar më 12 qershor 2025 në Prishtinë. Të dy grupet përfshinin pjesëmarrës nga zonat urbane dhe gjysmurbane nga e gjithë Kosova dhe siguruan ekuilibër gjinor; dhe

- Një fokus grup me profesionistë të medias, përfshirë redaktorë, gazetarë dhe menaxherë të mediave dixhitale nga televizioni dhe platformat online, i zhvilluar më 13 qershor 2025 në Prishtinë².

Këto metoda ofrojnë një bazë cilësore për të kuptuar se si grupet e ndryshme shoqërore dhe profesionale interpretojnë marrëdhënien në zhvillim ndërmjet medias dhe demokracisë në Kosovë dhe se si kjo marrëdhënie mund të forcohet në vitet e ardhshme.

2 Çdo seancë zgjati ndërmjet 90 dhe 120 minuta dhe u regjistrua me audio, u transkriptua dhe u analizua tematikisht sipas kornizës së kodimit të parashikuar në Udhëzimet e Përgjithshme Metodologjike. Informacione shtesë mbi pjesëmarrësit e fokus grupeve gjenden në Shtojcën nr. 1

II.

MENDIME MBI MEDIAN, GAZETARINË DHE DEMOKRACINË

Një shqetësim qendror i ngritur në të gjitha fokus grupet është shkëputja në rritje ndërmjet audiencës së re dhe gazetarisë vendore. Profesionistët e medias vërejtën se të rinjtë gjithnjë e më shumë konsumojnë informacion nëpërmjet përmbajtjes në gjuhën angleze në rrjetet sociale, në vend të burimeve lokale të lajmeve, duke dobësuar lidhjen kulturore dhe angazhimin qytetar. Një redaktor i një medie online paralajmëroi: “Të rinjtë sot marrin informacion vetëm në anglisht nëpërmjet reels dhe rrjeteve sociale, dhe po humbasin interesin për të lexuar informacion në gjuhën e tyre amtare”. Ky ndryshim po riformëson ekosistemin e informacionit në mënyra që marginalizojnë mediat e Kosovës dhe zvogëlojnë njohurinë e publikut mbi çështjet lokale.

Pjesëmarrësit, gjithashtu, përshkruan një antagonizëm në thellim ndërmjet aktorëve politikë dhe medias, i rrënjësuar në vite retorikë delegjitimizuese nga zyrtarët publikë. Gazetarët argumentuan se diskursi politik armiqësor ka normalizuar mosbesimin publik. Qytetarët në masë të madhe janë pajtuar se, edhe pse censura e drejtpërdrejtë ka shënuar rënie, influenca politike indirekte, veçanërisht në nivel lokal, mbetet e zakonshme, në mediat lokale që mbesin të cënueshme për shkak të varësisë së tyre nga financimi dhe reklamat nga institucionet komunale.

Një tjetër temë që dominonte diskutimet është pasiguria financiare e sektorit mediatik. Gazetarët përshkruan gjerësisht vitin 2025 si një nga vitet më të vështira ekonomikisht për profesionin, me tërheqjen e donatorëve dhe tkurrjen e të ardhurave nga reklamat. Shumë argumentuan se këto presione kanë krijuar kushte të “censurës ekonomike”, ku dobësitë financiare formësojnë vendimet editoriale. Siç shpjegoi një pjesëmarrës: “Hapëm një thirrje për grante të vogla deri në 5,000 euro dhe morëm 50 aplikime... konkurrenca për fondet është e jashtëzakonshme” (redaktor menaxhues, media online, Prishtinë). Kjo mungesë e burimeve ushqen vetëcensurën, dobëson raportimin e pavarur dhe lë mediat duke u përpjekur të mbajnë gjallë punën hulumtuese.

Gazetarët përshkruan gjerësisht vitin 2025 si një nga vitet më të vështira ekonomikisht për profesionin, me tërheqjen e donatorëve dhe tkurrjen e të ardhurave nga reklamat.

Këto presione ekonomike kontribuojnë në një rënie më të madhe të standardeve profesionale, sepse redaksitë gjithnjë e më shumë mbështeten tek gazetarët e paguar pak, pra të papërvojë, si dhe në prodhim të shpejtë të përmbajtjeve. Si gazetarët, ashtu edhe qytetarët vënë në dukje përhapjen e sensacionalizmit, analizave sipërfaqësore dhe “kokave që flasin”. Qytetarët e rinj shprehën pakënaqësi ndaj formateve të debatit me cilësi të ulët, duke u ankuar për “analistë që flasin për gjithçka edhe pse u mungon ekspertiza”. Gazetarët në moshë ia atribuojnë këtë rënie shkatërrimit të mentorimit editorial dhe mospërputhjes ndërmjet pritshmërive të gazetarëve të rinj dhe kërkesave të gazetarisë rigoroze.

Pjesëmarrësit nga të dy grupet theksuan përkeqësimin e kulturës së redaksisë dhe vështirësitë e të nxëniet të dije. Redaktorët përshkruan gazetarët e rinj si më pak të durueshëm ndaj trajnimeve dhe më të etur për të mbuluar lajmet kryesore, pa i zotëruar paraprakisht aftësitë bazë. Një pjesëmarrës i medias shpjegoi vështirësinë: “Është bërë shumë e vështirë t’i thuash një gazetari të ri të ulet me mua që ta mësoj se si bëhet kjo punë” (redaktor, televizion, Prishtinë). Ky hendek në zhvillimin profesional dobëson qëndrueshmërinë e standardeve gazetareske dhe aftësinë e redaksive për të funksionuar si hapësira të mësimi etik dhe qytetar.

Në të njëjtën kohë, ngritja e influencësve dhe krijuesve dixhitalë u pa si një kërcënim si ekonomik, ashtu edhe kulturor për gazetarinë. Profesionistët e medias vërejtën se buxhetet e reklamave gjithnjë e më shumë shkojnë te personazhet e rrjeteve sociale, ku popullariteti - e joprofesionalizmi - përcaktojnë vlerën në treg.

Siç e shpjegoi një pjesëmarrës: “Papritmas vjen një TikToker ose YouTuber dhe krijon konkurrencë të paligjshme, duke marrë marrëveshje kompanishë thjesht sepse ka shtrirje dhe shikime” (gazetar, media online, Prishtinë). Ky ndryshim dobëson qëndrueshmërinë financiare të redaksive dhe mjegullon kuptimin publik të asaj që përbën gazetaria krahasuar me argëtimin.

Qytetarët, gjithashtu, shprehën shqetësim për mungesën e llogaridhënies institucionale, duke vënë në dukje se gazetaria hukumtuese, pavarësisht sa e fuqishme është, shpesh nuk sjell pasoja të prekshme ligjore ose politike. Një pjesëmarrës, qytetar, përmbledh këtë ndjenjë duke thënë se hulumtimet e rëndësishme “zbulojnë shkelje pa prodhuar rezultate”, gjë që për pasojë kontribuon në zhgënjimin publik dhe ngritjen e dilemave mbi efikasitetin e raportimit si mjet demokratik në aspektin e monitoruesit.

Një tjetër sfidë e identifikuar në të gjitha fokus grupet lidhet me ngacmimet, kërcënimet dhe rreziqet për sigurinë personale që përballen gazetarët, veçanërisht gratë dhe gazetarët hulumtues. Gazetarët përshkruan një klimë frike dhe lodhjeje, të formuar nga keqtrajtime online, fushata shpifjeje dhe

sulme të koordinuara me qëllim të heshtjes së zërave kritikë. Siç vuri në dukje një pjesëmarrës: “Gazetaret gra dhe gazetarët hulumtues përballen me trajtimin më të ashpër, shpesh nëpërmjet keqtrajtimeve online ose kërcënimeve të synuara” (grua, 32 vjeçare, Prishtinë). Këto presione demotivojnë raportimin kritik dhe dobësojnë aftësinë e sektorit për të kryer funksionin e tij të mbikëqyrjes demokratike.

Peizazhi më i gjerë i informacionit kërcënohet, gjithashtu, nga përhapja e portaleve online me cilësi të ulët, shpesh të krijuara nga individë të papërvojë që injorojnë standardet profesionale. Profesionalistët e medias vërejtën se shumë të rinj krijojnë faqe lajmesh online menjëherë, pa trajnim ose mbikëqyrje editoriale. Një pjesëmarrës i medias shpjegoi: “Interesi për të bërë gazetari po bie, por shumë të rinj pa përvojë hapin menjëherë portalet e tyre online” (redaktor, televizion, Prishtinë). Ky trend kontribuon në ndotjen e informacionit, dobëson besueshmërinë dhe e vështirëson më tej përpjekjen e qytetarëve për të identifikuar burime të besueshme.

Së fundi, pjesëmarrësit theksuan krizën ekzistenciale me të cilën përballen mediat lokale, të cilat mbeten pjesa më e dobët e ekosistemit mediatik, por më thelbësore për demokracinë në nivel komuniteti. Mediat lokale u përshkruan si jashtëzakonisht të cënueshme ndaj presionit politik, varësisë ekonomike dhe vetëcensurës. Një redaktor sugjeroi një zgjidhje strukturore, duke theksuar: “Duhet të ndjekim modelin e Sllovenisë, shtet ky që subvencionon mediat lokale për të shkruar mbi kulturë, arsimin dhe çështjet e komuniteteve” (redaktor, media online, Prishtinë). Pa ndërhyrje të tilla, pjesëmarrësit paralajmëruan se mund të krijohen “shkretëtira informacioni” jashtë qyteteve kryesore, duke dobësuar më tej pjesëmarrjen demokratike.


Pavarësisht të gjitha këtyre sfidave - armiqësisë politike, paqëndrueshmërisë ekonomike, rënies së profesionalizmit dhe kërcënimeve për sigurinë, pjesëmarrësit në të gjitha grupet theksuan vlerën e qëndrueshme demokratike të gazetarisë. Siç e shprehu një qytetar thjesht: “Gazetaria mbetet një shtyllë e demokracisë” (burrë, 44 vjeçar, Gjakovë). Ky besim pasqyron, njëkohësisht, si një njohje të presioneve me të cilat po përballen gazetaria, ashtu edhe një vlerësim të rolit të saj të pazëvendësueshëm në mbrojtjen e interesit publik.

III.

REFLEKTIME MBI TRENDET DHE RREZIQET E IDENTIFIKUARA NË FAZËN E PARË TË HULUMTIMIT

Faza e parë e hulumtimit identifikoi rënien e besimit si trendin më të dukshëm dhe shqetësues në mjedisin mediatik të Kosovës. Të dhënat nga Barometri Ballkanik 2024 tregojnë se besimi publik në media ka rënë nga 50% në 30%, rënia më e madhe krahasuar me besimin te qeveria ose parlamenti (RCC, 2024). Si gazetarët, ashtu edhe qytetarët e kuptuan këtë rënie jo si një ndryshim të papritur, por si pasojë e problemeve strukturore kumulative.

Grafiku 1: **BESIMI I PUBLIKUT NË MEDIA, QEVERI DHE PARLAMENT**
- KOSOVË (2023 VS. 2024)



Të dhënat e regjistrimit nga Departamenti i Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës tregojnë një trend shqetësues që shpërfaq rënien e interesimit të studentëve për gazetarinë si fushë studimi.


Faktori i parë kryesor që nxit rënien e besimit lidhet me natyrën në zhvillim të presionit politik, i cili ka kaluar nga censura e hapur te forma më fine, por të përhapura të delegjitimizimit. Të dhënat e RSF dhe dëshmitë nga fokus grupet tregojnë se aktorët politikë përdorin gjithnjë e më shumë retorikë që minon besueshmërinë e gazetarëve (RSF, 2025). Sipas Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK, 2025a), nga 35 reagime publike mbi sigurinë e gazetarëve të lëshuara ndërmjet janarit dhe tetorit 2025, 24 përfshinin aktorë politikë dhe përfshinin sulme verbale ose fushata shpifjeje. Gazetarët përshkruan pasojat psikologjike të armiqësisë së tillë. Siç shpjegoi një pjesëmarrës: “Qeveria ka investuar vite në gjuhë që delegjitimon mediat” (gazetar, media online, Prishtinë). Qytetarët ndanë këtë pikëpamje, duke argumentuar se një retorikë e tillë “i mëson publikut të mos respektojë gazetarët”, duke normalizuar një mjedis ku raportimi kritik lehtësisht përjashtohet në kontekstin e besueshmërisë dhe konsiderohet i motivuar politikisht.

Faktori i dytë kryesor që ndikon këtë trend lidhet me shkeljet sistematike etike brenda sektorit mediatik. Të dhënat nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK, 2025a) tregojnë se ndërmjet janarit dhe shtatorit 2025 u depozituan 90 ankesa kundër mediave online, ku 46 u konfirmuan si shkelje të Kodit të Etikës. Afërsisht 90% përfshinin shkelje të Nenit 2 (Raportimi i së vërtetës), ndërsa shumë shkelën edhe Nenin 4 (E drejta për t’u përgjigjur).

Një trend tjetër negativ i identifikuar në fazën e parë të hulumtimit lidhet me zvogëlimin e numrit të gazetarëve të ardhshëm, gjë që kërcënon qëndrueshmërinë afatgjatë të profesionit. Të dhënat e regjistrimit nga Departamenti i Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës tregojnë një trend shqetësues që shpërfaq rënien e interesimit të studentëve për gazetarinë si fushë studimi. Pas kulmit prej 135 studentësh në vitin akademik 2021/2022, regjistrimet ranë më shumë se gjysma më 2022/2023 dhe, që nga atëherë kanë mbetur të ulëta, duke shënuar rreth 60–65 studentë të regjistruar në vit. Ky trend në rënie shpalos rënien e interesimit të të rinjve për profesionin, indikator ky i hershëm i sfidave në kontekstin e ripërtëritjes dhe qëndrueshmërisë së gazetarisë.

Grafiku 2: NUMRI I STUDENTËVE TË GAZETARISË NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Numri i studentëve të gazetarisë në nivelin BA të regjistruar në Universitetin e Prishtinës (2020-2025)



Burimi: Universiteti i Prishtinës

Redaktorët me përvojë e interpretuan këtë trend si një tregues i një krize më të thellë të identitetit profesional. Një redaktor vuri në dukje se “të rinjtë nuk duan më të studiojnë gazetari dhe ata që hyjnë në redaksi mendojnë se dinë tashmë gjithçka për shkak të mediave sociale” (redaktor, televizion, Prishtinë).

Së fundi, të gjitha këto rreziqe përkthehen në përkeqësimin e mjedisit të përgjithshëm të lirisë së medias në Kosovë, siç pasqyrohet në Indeksin e Lirisë së Mediave. Ndërmjet viteve 2022 dhe 2025, Kosova kaloi nga një situatë “problematike por në përmirësim” në një situatë “të vështirë dhe në rënie”, me regres të konsiderueshëm në treguesit politikë, ekonomikë, ligjorë, socialë dhe të sigurisë.

Tabela 1. KOSOVË – INDEKSI I LIRISË SË SHTYPIT RSF (2022–2025) ME KLASIFIKIMIN

Viti	Rangimi /180	Pikët	Klasifikimi	Politik	Ekonomik	Legjislativ	Social	Siguria
2022	61	67.00	Situata problematike ●	64.34 ●	45.24 ●	80.85 ●	74.33 ●	70.26 ●
2023	56	68.38	Situata problematike ●	62.95 ●	50.28 ●	80.26 ●	75.49 ●	72.95 ●
2024	75	60.19	Situata e vështirë ●	56.61 ●	48.05 ●	73.92 ●	67.56 ●	54.81 ●
2025	99	52.73	Situata e vështirë ●	44.61 ●	39.88 ●	68.54 ●	57.28 ●	53.35 ●

● Mirë (85–100) ● Kënaqshme (75–84.9) ● Problematike (65–74.9)
 ● E vështirë (45–64.9) ● Shumë serioze (0–44.9)

Kategoria politike pësoi rënien më dramatike - me një rënie prej 19.73 pikësh në 44.61 - duke vendosur Kosovën në rangun “shumë serioz” sipas shkallës së RSF. Pjesëmarrësit e fokus grupeve e lidhën fort këtë mjedis me rritjen e vetëcensurës. Siç vuri në dukje një gazetar: “Me këtë nivel armiqësie, shumë kolegë shmangin temat e ndjeshme, sepse nuk duan të sulmohen ose poshtërohen online” (gazetar, media online, Prishtinë).

Në përmbledhje, faza e parë e hulumtimit zbuloi një mjedis mediatik, i cili përballlet me shkelje etike që minojnë besueshmërinë, armiqësi politike që ushqen sulmet ndaj reputacionit, pasiguri ekonomike që deformon prodhimin e lajmeve dhe një zvogëlim të numrit të profesionistëve të rinj që hyjnë në fushë. Këto modele, së bashku me gjetje shtesë lidhur me përdorimin e medias dhe besimin publik, shpjegohen edhe më tej, nëpërmjet perspektivave dhe përvojave të përjetuara që ndanë pjesëmarrësit në diskutimet e fokus grupeve.

IV.

PËRDORIMI I MEDIAS DHE BESIMI

Kjo pjesë shqyrton se si qytetarët dhe profesionistët e medias në Kosovë konsumojnë, vlerësojnë dhe besojnë në media brenda një ekosistemi gjithnjë e më dixhital të informacionit. Duke u mbështetur në diskutimet e fokus grupeve, këtu analizohen zakonet në zhvillim të përdorimit të medias, dallimet ndërbreznore, roli i platformave dixhitale dhe ndryshimet në perceptimet e besueshmërisë dhe llogaridhënies. Tri dinamika dominojnë këtë peizazh: (1) migrimi nga mediat tradicionale te platformat online, (2) rritja e skepticizmit ndaj rrjeteve sociale, dhe (3) qëndrueshmëria e besimit selektiv për disa media. Pjesëmarrësit në të gjitha fokus grupet ranë dakord se qasja në informacion në Kosovë është zgjeruar ndjeshëm gjatë dekadës së fundit, nuk do mend e nxitur nga dixhitalizimi dhe teknologjia mobile. Qytetarët e rinj mbështeten kryesisht në portalet online të lajmeve, platformat e rrjeteve sociale dhe aplikacionet e telefonëve mobilë për konsumimin e lajmeve. Instagram, Facebook dhe TikTok u përmendën si burime të përshtatshme dhe të menjëhershme, sado që pjesëmarrësit pranuan se këto platforma nuk janë gjithmonë të besueshme: “Lajmet i marr kryesisht nga rrjetet sociale, sidomos nga Instagrami” (grua, 22 vjeçare, Prishtinë).

Qytetarët më në moshë, nga ana tjetër, përshkruan një model hibrid të konsumimit, duke kombinuar shfletimin online me lajmet televizive dhe, në masë më të vogël, transmetimet e radios. Shumë shprehën nostalgji për thellësinë dhe disiplinën editoriale që dikur lidhej me gazetarinë tradicionale: “Në Facebook i kam ‘unfollow’ të gjitha mediat, i shfletoj vetëm faqet e mediave që u besoj drejtpërdrejt” (burrë, 48 vjeç, Deçan).

Të dy brezat vërejtën zhdukjen e gazetave të printuara dhe normalizimin e një kulture “informacioni të lirë”, ku audiencat presin qasje të pakufizuar online dhe informacione pa pagesë. Siç e përmbledhi një pjesëmarrës: “Tani besojmë se gjithçka duhet të na vijë falas, online” (burrë, 35 vjeç, Gjilan).

Profesionistët e medias konfirmuan këto trende, duke i përshkruar si një shpatë me dy tehe: dixhitalizimi ka demokratizuar qasjen, por e ka dëmtuar qëndrueshmërinë. Ata besojnë se audiencat gjithnjë e më shumë konsumojnë lajme në mënyrë indirekte, nëpërmjet feed-eve të rrjeteve sociale, në vend që të

Qytetarët e rinj mbështeten kryesisht në portalet online të lajmeve, platformat e rrjeteve sociale dhe aplikacionet e telefonëve mobilë për konsumimin e lajmeve. Instagram, Facebook dhe TikTok u përmendën si burime të përshtatshme dhe të menjëhershme.

marrin informacion direkt nga faqet e mediave. “Nuk kemi kulturë abonimesh. Kush kontrollon paratë, kontrollon mesazhin”. (gazetar, media online, Prishtinë)

Pjesëmarrësit, gjithashtu, vunë re se bizneset lokale tani reklamojnë drejtpërdrejt në platformat e rrjeteve sociale, duke shmangur mediat profesionale. Ky ndryshim ka privuar mediat tradicionale nga të ardhurat jetike, duke i shtyrë drejt strategjive më komerciale, të fokusuara në klikime: “Influencuesit e TikTok-ut paguhen ose marrin reklama po aq sa një radiostacion. Ne paguajmë taksa, ata jo”. (gazetar, media transmetuese, Prishtinë)

Pjesëmarrësit në të gjitha grupet shprehën një skepticizëm të madh ndaj portaleve online dhe rrjeteve sociale, si burime të besueshme informacioni. Qytetarët e moshës së re përshkruajnë shumicën e portaleve si politikisht të njëanshme dhe të orientuara më shumë nga klikimet se sa nga faktet: “Çdo portal online mbështet një anë politike dhe kjo duket në shkrimet e tyre” (burrë, 26 vjeçar, Ferizaj); “Shumë portale injorojnë plotësisht etikën, kurse disa postojnë gjithçka thjesht për klikime” (grua, 22 vjeçare, Prishtinë).

Pjesëmarrësit më në moshë ndanë këtë shqetësim, por treguan besim më të madh te lajmet televizive dhe programet hulumtuese, të cilat i lidhën me standarde profesionale dhe mbikëqyrje editoriale. Profesionistët e medias konfirmuan se kufijtë e mjegulluar ndërmjet raportimit dhe komentimit kanë hutuar audienat dhe kanë dobësuar besimin publik: “Njerëzit duhet të mësojnë dallimin ndërmjet një raporti dhe një opinioni. Edhe disa gazetarë nuk e dinë” (redaktor, media online, Prishtinë).

Ky skepticizëm ka ndikuar, gjithashtu, në mënyrat e angazhimit. Derisa shumica e qytetarëve konsumojnë lajme çdo ditë, pak nga ta ndërveprojnë aktivisht me mediat duke dhënë komente ose duke dorëzuar ankesa. Megjithatë, qytetarët më të moshuar vunë re një ndërgjegjësim në rritje për mekanizmat e llogaridhënies, si Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës dhe Komisioni i Pavarur i Mediave: “Tani ka më shumë ndërgjegjësim për kontrollin e fakteve dhe përgjegjësi për përmbajtje, por kryesisht tek lexuesit me njohuri mediatike” (redaktor, televizion, Prishtinë).

Pavarësisht skepticizmit, pjesëmarrësit ruajtën një besim selektiv te një numër i kufizuar i mediave si të besueshme. Këto ishin zakonisht platforma lokale të konsoliduara, të njohura për standardet etike dhe transparencën. Megjithatë, besimi gjithnjë e më shumë ka migruar nga institucionet tek individët, bloggerët, komentatorët dhe influencuesit, të cilët shpesh veprojnë jashtë kornizave profesionale.

“Ne po konkurrojmë me influencersit për audiencë e reklamues të njëjtë. Ata kanë ndjekësit, ne kemi Kodin e Etikës”. (redaktor, media online, Prishtinë)

Kjo zhvendosje drejt ekosistemeve të lajmeve të drejtuara nga personalitetet ka megjulluar llogaridhënien dhe ka thelluar polarizimin, pasi audiencat tani priren të ndjekin individët me të cilët pajtohen, në vend të institucioneve që mund të verifikojnë. Pjesëmarrësit më të moshuar shprehën nostalgji për një epokë kur “lajmet verifikoheshin para se të arrinin te publiku”, ndërsa të rinjtë vlerësojnë diversitetin e zërave online, por dyshojnë në besueshmërinë e tyre.

V.

NEVOJAT DHE KËRKESAT E QYTETARËVE

Ka pritshmëri të ndryshme ndërmjet qytetarëve të Kosovës lidhur me përmbajtjen mediatike, përfaqësimin dhe etikën. Kjo pjesë shqyrton perceptimet e tyre mbi cilësinë dhe diversitetin e medias, ndjenjën e tyre nëse përfaqësohen në mënyrë të mjaftueshme dhe mënyrat në të cilat angazhohen me përmbajtjen gazetareske.

Në dy fokus grupet me qytetarë, pjesëmarrësit shprehën një bindje të fortë se qytetarët e Kosovës presin më shumë nga mediat e tyre, më shumë substancë, diversitet, etikë dhe llogaridhënie. Pjesëmarrësit nga të gjithë brezat u pajtuan se mediat janë bërë tepër të politizuara dhe sensacionale, shpesh duke i dhënë rëndësi primare konfliktit dhe kontradiktave dhe duke i vendosur ato mbi raportimin për interes publik. Qytetarët kërkuan gazetari që edukon, informon dhe reflekton realitetet e komuniteteve të tyre, ndërsa profesionistët e medias theksuan se një gazetari i tillë është gjithnjë e më e vështirë për t'u mbajtur brenda një sistemi të rrënuar financiarisht.

Pjesëmarrësit më të rinj ishin veçanërisht të zëshëm për lodhjen nga përmbajtjet politike. Ata përshkruan peizazhin mediatik si të dominuar nga debate politike të përsëritura dhe të polarizuara, që pasqyrojnë retorikën e politikanëve në rrjetet sociale, në vend që ta hulumtojnë atë. Në vend të kësaj, ata shprehën interes për mbulim që është si informues, ashtu edhe i lidhur me jetën e përditshme, duke u fokusuar te arsimi, punësimi dhe jeta sociale. Një pjesëmarrëse tha: "Preferoj lajmet për showbiz dhe sport. Historitë politike thjesht përsërisin atë që thonë politikanët në Facebook" (grua, 21 vjeçare, Prishtinë). Një pjesëmarrës tjetër tha: "Mediat duhet të fokusohen më shumë te arsimi i të rinjve dhe çështjet sociale, jo vetëm tek politika" (burrë, 24 vjeçar, Gjilan).

Qytetarët më të moshuar, nga ana tjetër, kërkuan gazetari më konstruktive dhe të orientuar drejt zhvillimit. Ata theksuan nevojën për raportim mbi ekonominë, bujqësinë dhe zhvillimin e komuniteteve, fusha që ata ndjenin se ishin të neglizhuara nga mediat kombëtare dhe lokale: "Nuk kemi mjaft histori për rritjen ekonomike ose bujqësinë. Fokusimi është gjithmonë tek politika" (burrë, 52 vjeçar, Prizren).

Të dy grupet u pajtuan se dominimi i mbulimit politik nuk pasqyron diversitetin e nevojave dhe interesave publike.

Të dy grupet u pajtuan se dominimi i mbulimit politik nuk pasqyron diversitetin e nevojave dhe interesave publike.

Nga ana tjetër, etika dhe profesionalizmi ishin tema qendrore në çdo diskutim. Qytetarët nga të gjitha grupmoshat shprehën shqetësim për rënien e standardeve gazetareske, veçanërisht tek portalet online. Ata ia atribuuan këtë rritje së numrit të gazetarëve pa përvojë dhe mungesës së mbikëqyrjes editoriale. Pjesëmarrësit kritikuan mediat sensacionale për vendosjen e tërheqjes së vëmendjes mbi saktësinë: "Mediat nuk duhet të ndjekin interesin publik vetëm për të tërhequr vëmendjen, por duhet t'i shërbejnë interesit publik me përgjegjësi" (burrë, 27 vjeçar, Mitrovicë).

Për më tepër, si qytetarët e rinj ashtu edhe ata më në moshë thanë se ndihen të pakënaqur me shkallën e përfaqësimit të tyre në media. Pjesëmarrësit e rinj thanë se perspektivat e tyre shfaqen kryesisht në histori argëtuese ose krimi, jo në diskutime mbi politika, kulturë apo jetën qytetare. Qytetarët më në moshë theksuan mungesën pothuajse totale të mbulimit të bazuar në komunitet, veçanërisht nga qytetet e vogla dhe zonat rurale. Shumë vunë në dukje se mediat lokale veprojnë gjithnjë e më shumë si "stacione transmetimi" për përmbajtje kombëtare, duke dështuar të kapin realitetet lokale: "Mediat lokale kanë ndaluar mbulimin e jetës në komunitet, ato thjesht kopjojnë njoftimet për media" (grua, 47 vjeçare, Ferizaj).

Një temë e përsëritur në të gjitha grupet lidhej me qëndrueshmërinë e gazetarisë së pavarur. Qytetarët u pajtuan përgjithësisht se financimi i mediave duhet të ndahet ndërmjet shtetit, donatorëve ndërkombëtarë dhe aktorëve privatë, por me masa strikte për transparencë dhe mosndërhyrje. Qytetarët e rinj ishin skeptikë ndaj financimit nga shteti, duke u frikësuar nga ndikimi politik.

Profesionistët e medias theksuan urgjencën e krijimit të një kuadri financimi transparent dhe të qëndrueshëm. Ata përshkruan një "vakuum financiar" pas tërheqjes së ndihmës nga donatorët dhe migrimit të reklamave te platformat e rrjeteve sociale. Shumë prej tyre mbështetën modele të përziera që kombinojnë subvencione shtetërore, kontribute nga donatorët dhe sponsorizime private nën mbikëqyrje të pavarur. Një pjesëmarrës tha: "Na duhet një mekanizëm financimi i qëndrueshëm. Pa të, etika dhe pavarësia janë të pamundura" (redaktor, media online, Prishtinë).

VI.

MENDIME MBI TË ARDHMEN E MEDIAS DHE GAZETARISË

Diskutimet mbi të ardhmen e medias dhe gazetarisë shpalojnë një përzierje shprese, ankthi dhe realizmi. Pjesëmarrësit në të tre fokus grupet, qytetarët e rinj, qytetarët më në moshë dhe profesionistët e medias, pranian se sistemi mediatik i Kosovës ndodhet në një udhëkryq. Ata pranojnë potencialin transformues të teknologjive dixhitale, Inteligjencës Artificiale (AI) dhe rrjeteve sociale, por njëkohësisht pajtohen që vlerat themelore si saktësia, etika dhe gjykimi njerëzor duhet të mbesin në epiqendër të mbijetesës dhe besueshmërisë në gazetarinë.

AI do të sfidojë gazetarinë, por gazetarët duhet të shkojnë vetë në terren, jo të presin që AI ta bëjë punën e tyre.

Qytetarët e rinj shprehën njëkohësisht fascinim dhe kujdes ndaj teknologjive të reja. Ata e panë AI-në si të pashmangshme dhe potencialisht të dobishme për efikasitetin, por frikësoheshin se mund të shkatërrojë autencitetin dhe mendimin kritik nëse përdoret në mënyrë të pakujdesshme. Shumë syresh theksuan se forca e gazetarisë qëndron në praninë njerëzore, empatinë dhe në të kuptuarit e kontekstit, cilësi këto që makinat nuk mund t'i riprodhojnë: "AI do të sfidojë gazetarinë, por gazetarët duhet të shkojnë vetë në terren, jo të presin që AI ta bëjë punën e tyre" (burrë, 26 vjeç, Gjilan).

Qytetarët më në moshë ndanë këtë pikëpamje, duke argumentuar se përparimi teknologjik duhet të përmirësojë, jo të zëvendësojë rolin e gazetarit. Për ta, besueshmëria varet nga llogaridhënia njerëzore, të cilën teknologjia vetëm nuk mund ta garantojë.

Profesionistët e medias përshkruan nga përvoja e tyre se si dixhitalizimi ka ndryshuar rutinat e redaksive. Ata vunë re se zhvendosja pas pandemisë drejt operacioneve online ka përshpejtuar dinamikën "shpejtësi mbi saktësi", duke dobësuar rishikimin editorial dhe mentorimin.

"Pas pandemisë, kaluam plotësisht online. Modeli është 'shpejtësi mbi saktësi'. Lidhja editoriale është thyer". (gazetar, media online, Prishtinë)

Pjesëmarrësit, po ashtu, ranë dakord se e ardhmja e gazetarisë në Kosovë varet po aq nga ekonomia sa dhe nga teknologjia. Qytetarët pranojnë se gazetaria cilësore kërkon kohë dhe burime, ndërsa profesionistët paralajmëruan se pasiguria e vazhdueshme financiare kërcënon pavarësinë editoriale dhe standardet etike.

Diskutimet zbuluan tre kërcënime strukturore të ndërlidhura që formojnë peizazhin financiar të medias. Së pari, tërheqja e mbështetjes nga donatorët ka lënë shumë media të pavarura pa financim të qëndrueshëm, veçanërisht ato të angazhuara në raportime hulumtuese dhe për interes publik. Së dyti, të ardhurat nga reklamat kanë rënë ndjeshëm, pasi bizneset lokale po zhvendosin gjithnjë e më shumë buxhetet e marketingut te platformat e rrjeteve sociale, duke shmangur mediat profesionale. Së treti, ky mjedis ka favorizuar përqendrimin e tregut, ku pronësia dhe ndikimi janë të përqendruar në pak duar.

Qytetarët më të rinj, gjithashtu, vunë në dyshim nëse audiencat e ardhshme do të jenë të gatshme të paguajnë për gazetari të besueshme. Përderisa qasja dixhitale ka demokratizuar informacionin, ajo njëkohësisht ka krijuar pritshmërinë që lajmet duhet të jenë falas, gjë që e bën të vështirë vendosjen e modeleve të qëndrueshme biznesore. Si për qytetarët, ashtu edhe për profesionistët, dobësia ekonomike e gazetarisë shihet si një nga rreziqet më urgjente për të ardhmen.

Profesionistët e medias theksuan, gjithashtu, se inovacioni teknologjik, si i vetëm, nuk mund ta mbajë industrinë në këmbë nëse nuk shoqërohet me një disiplinë të ripërtërirë profesionale dhe përkushtim etik. Ata bënë thirrje për rikthimin e hierarkive editoriale, mentorimit të strukturuar dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional për të rindërtuar integritetin brenda dhomës së lajmeve. Shumë argumentuan se vetërregullimi, më shumë sesa ndërhyrja shtetërore, mbetet mjeti më efektiv për ruajtjen e standardeve dhe besimit të publikut.

Pavarësisht shqetësimeve për presionin politik, brishtësinë financiare dhe tronditjet teknologjike, shumë pjesëmarrës shprehën optimizëm të qëndrueshëm. Profesionistët theksuan guximin dhe këmbënguljen e gazetarëve që vazhdojnë të hetojnë korrupsionin dhe padrejtësitë. Ata e përshkruan gazetarinë jo thjesht si një profesion, por si një mision qytetar, të ndërtuar mbi kureshtjen, integritetin dhe guximin: "Gazetarët nuk dorëzohen kurrë. Na kanë dekurajuar, por nuk na e kanë marrë guximin" (gazetar, televizion, Prishtinë).

Qytetarët e ndanë këtë optimizëm, duke shprehur krenari për traditën e lirisë së medias në Kosovë dhe rolin e saj mbikëqyrës në jetën demokratike. Ndjenja kolektive nuk kishte të bënte me dilemën nëse gazetaria do të mbijetojë, por me llojin e gazetarisë që do ta përkufizojë dekadën e ardhshme: një gazetari

e udhëhequr nga etika dhe shërbimi publik, apo një gazetari e dominuar nga algoritmet dhe klikimet.

Kur u pyetën të imagjinonin të ardhmen e gazetarisë, pjesëmarrësit nga të gjitha grupet bënë thirrje për një sistem mediatik më etik, gjithëpërfshirës dhe të përqendruar te njeriu. Qytetarët theksuan saktësinë, balancën dhe empatinë; profesionistët shtuan qëndrueshmërinë, mentorimin dhe përshtatjen dixhitale si prioritete jetike: “Gazetarët duhet të jenë më të kujdesshëm, më të saktë dhe të mos ndikohen nga preferenca personale apo politike” (grua, 25 vjeçare, Prishtinë).

Në përgjithësi, pjesëmarrësit besojnë se e ardhmja e gazetarisë në Kosovë do të varet nga tre kushte. I pari është ripërtëritja etike dhe profesionale, që kërkon forcimin e mentorimit, rikthimin e hierarkive editoriale dhe përforcimin e vetërregullimit si mjet llogaridhënieje publike. I dyti është qëndrueshmëria financiare, e arritur nëpërmjet modeleve transparente dhe të larmishme të financimit që mbrojnë pavarësinë editoriale nga presionet politike apo komerciale. I treti është përshtatja teknologjike me mbikëqyrje njerëzore, ku AI dhe mjetet dixhitale përdoren për të forcuar misionin qytetar të gazetarisë duke e mbështetur, e jo duke e zëvendësuar gjykimin njerëzor, empatinë dhe integritetin që e përkufizojnë profesionin.

VII.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Gjetjet nga të dy fazat e projektit “E ardhmja e medias në Kosovë” paraqesin një ekosistem mediatik që është njëkohësisht dinamik dhe i brishtë. Mediat në Kosovë mbeten ligjërish të lira, të avancuara dixhitalisht dhe të larmishme në formë, por funksionojnë nën presion gjithnjë e më të madh nga armiqësia politike, pasiguria ekonomike dhe një krizë e thelluar e besimit publik. Në të gjitha fokus grupet, pjesëmarrësit identifikuan besimin si vijën kryesore të përthyerjes së sistemit mediatik në vend. Qytetarët sot konsumojnë më shumë informacion se kurrë më parë, por gjithnjë e më pak i besojnë asaj që lexojnë apo shikojnë. Shkeljet etike të dokumentuara nga Këshilli i Mediave të Shkruara i Kosovës, të kombinuara me sulmet e vazhdueshme politike dhe varësinë financiare, e kanë minuar gradualisht besueshmërinë e gazetarisë si institucion demokratik.

Revolucioni dixhital ka demokratizuar shprehjen dhe ka përshpejtuar qarkullimin e informacionit, por njëkohësisht ka fragmentuar audiencat, ka intensifikuar konkurrencën dhe ka turbulluar kufirin mes gazetarisë dhe opinionit. Megjithatë, pavarësisht këtyre sfidave, hulumtimi zbulon baza të forta për ripërtëritje. Qytetarët dhe profesionistët e medias ndajnë një vizion të përbashkët për një gazetar etike, shoqërisht të angazhuar dhe të pavarur, duke treguar se reforma jo vetëm që është e nevojshme, por edhe e mundshme. Mediat në Kosovë vazhdojnë të shërbejnë si një shtyllë e demokracisë - duke mbajtur pushtetin përgjegjës, duke zbuluar korrupsionin dhe duke formësuar debatin publik.

Pavarësisht shqetësimeve të përhapura për anshmëri, presion politik dhe rënie të standardeve, qytetarët shprehën një optimizëm të matur për të ardhmen e gazetarisë në Kosovë. Shumë besojnë se besueshmëria mund të rikthehet nëpërmjet një angazhimi të ripërtërirë ndaj saktësisë, pavarësisë dhe raportimit etik. Pjesëmarrësit e rinj, në veçanti, theksuan nevojën për një gazetar që “flet të vërtetën pa frikë” dhe që i shërben publikut, e jo interesave politike apo komerciale. Sipas tyre, e ardhmja e medias në Kosovë do të varet nga rindërtimi i besimit dhe ruajtja e gazetarisë, si një e mirë themelore demokratike.

Pavarësisht shqetësimeve të përhapura për anshmëri, presion politik dhe rënie të standardeve, qytetarët shprehën një optimizëm të matur për të ardhmen e gazetarisë në Kosovë.

Bazuar në këto gjetje, rekomandimet në vijim paraqesin veprimet kyçe të nevojshme për të forcuar integritetin e medias, për të rritur besimin publik dhe për të mbështetur një peizazh mediatik më të qëndrueshëm dhe të pavarur në Kosovë, duke u drejtuar politikëbërësve dhe institucioneve, organizatave dhe profesionistëve të medias, si dhe donatorëve dhe komunitetit ndërkombëtar.

Për politikëbërësit dhe institucionet

- Institucionet shtetërore duhet të garantojnë mbrojtje ligjore dhe institucionale për gazetarët, duke forcuar mekanizmat e zbatimit për rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj tyre, përmes ndjekjes më të shpejtë gjyqësore dhe transparencës publike mbi epilogun e rasteve.
- Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me komunitetin e medias, duhet të integrojnë protokollet e sigurisë së gazetarëve në procedurat policore dhe prokuroriale, duke respektuar pavarësinë e gjyqësorit.
- Qeveria qendrore dhe autoritetet komunale duhet të sigurojnë shpërndarje transparente dhe të drejtë të fondeve publike, duke miratuar kriteret e qarta për ndarjen e reklamave shtetërore dhe komunale, me qëllim parandalimin e favorizimit politik.
- Duhet të krijohet një organ i pavarur monitorues, i mbështetur nga institucionet publike, por i qeverisur bashkërisht nga shoqëria civile, akademja dhe sektori i medias, për të parë marrëdhëniet financiare ndërmjet qeverisë dhe medias.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit duhet ta promovojë edukimin medial si prioritet të politikave publike, duke integruar edukimin mediatik dhe dixhital në kurrikulat shkollore nga arsimi fillor deri në atë universitar.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, së bashku me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe në partneritet me shoqërinë civile dhe organizatat mediatike, duhet të mbështesin fushata publike që promovojnë verifikimin e fakteve, mendimin kritik dhe shpërndarjen e përgjegjshme të informacionit.

Për organizatat dhe profesionistët e medias

- Mediat, redaktorët, Këshilli i Mediave të Shkruara i Kosovës, shoqatat e gazetarisë dhe shkollat e gazetarisë duhet të rindërtojnë standardet etike dhe editoriale duke forcuar mentorimin në redaksi dhe hierarkitë editoriale, për të rikthyer verifikimin dhe llogaridhënien; duke zgjeruar vetërregullimin nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve dhe relevancës së KMSH-së dhe duke inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet redaksive, shkollave të gazetarisë dhe organizatave mbikëqyrëse, për të ndërtuar një kulturë të të mësuarit mes kolegëve dhe reflektimit etik.

- Organizatat mediatike, universitetet, shoqatat profesionale dhe organizatat për zhvillimin e medias, me mbështetjen e donatorëve, duhet të investojnë në trajnim dhe arsim profesional duke krijuar programe të vazhdueshme zhvillimi profesional mbi AI-në, gazetarinë e të dhënave dhe metodat hulumtuese; si dhe duke rigjallëruar arsimin e gazetarisë nëpërmjet partneriteteve me universitete dhe organizata të zhvillimit të medias, për të lidhur teorinë me praktikën.

- Pronarët e mediave, donatorët dhe partnerët e industrisë, me mbështetje publike transparente kur është e përshtatshme, duhet të diversifikojnë dhe sigurojnë financimin e medias duke zhvilluar modele të qëndrueshme financimi që kombinojnë të ardhurat komerciale, mbështetjen shtetërore dhe grantet ndërkombëtare nën kushte strikte transparence; si dhe duke inkurajuar modele të mbështetura nga audienca, përfshirë anëtarësime, financim kolektiv (crowdfunding) dhe mikro-abonime, për të ulur varësinë nga donatorët dhe reklamuesit.

Për donatorët dhe komunitetin ndërkombëtar

- Donatorët ndërkombëtarë dhe organizatat për zhvillimin e medias duhet të kalojnë nga grantet afatshkurtra drejt mbështetjes sistematike duke lëvizur përtej ndihmës së bazuar në projekte drejt financimit institucional afatgjatë që siguron vazhdimësi editoriale dhe zhvillim të stafit; si dhe duke mbështetur iniciativë rajonale që promovojnë bashkëpunimin ndërkufitar, gazetarinë hulumtuese dhe qëndrueshmërinë ndaj dezinformimit.

- Donatorët ndërkombëtarë, organizatat për zhvillimin e medias dhe partnerët teknologjikë duhet të inkurajojnë inovacionin dhe përdorimin etik të teknologjisë duke financuar eksperimente me mjete të bazuara në AI për verifikim, kontroll faktesh dhe analizë të përmbajtjes, duke ruajtur mbikëqyrje të fortë etike; si dhe duke mbështetur iniciativë të transformimit dixhital që rrisin qëndrueshmërinë dhe transparencën e redaksive, në vend që të zëvendësojnë fuqinë punuese në gazetareske.

REFERENCAT DHE BURIMET

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. (2025a). *Annual summary of political threats against journalists (Jan–Oct 2025)*. Prishtina: AGK.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. (2025b). *AGK-ja e dënon fushatën e vazhdueshme kundër mediave dhe gazetarëve nga kryeministri Kurti dhe Vetëvendosje (07 February 2025)*.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. (2025c). *Akuzat dhe insinuatat e Presidentes Osmani rrezikojnë sigurinë fizike të gazetarëve (11 September 2025)*.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. (2025d). *AGK-ja dënon sulmet ndaj gazetarëve nga kryeparlamentari Basha (28 August 2025)*.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. (2025e). *AGK-ja dënon paralajmërimin intimidues të Faton Pecit kundër disa gazetarëve (15 October 2025)*.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. (2025f). *Komunikata e Menaxhmentit të RTK-së është intimidim publik ndaj 6 redaktorëve (27 August 2025); AGK-ja dënon përjashtimin arbitrar nga ekrani të 6 gazetarëve të RTK-së (25 August 2025)*.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. (2025g). *AGK-ja kundër bojkotit të Vetëvendosjes ndaj mediave (09 January 2025); AGK-ja dënon fushatën linçuese të Vetëvendosjes kundër televizionit Klan Kosova (22 April 2025)*.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. (2025h). *AGK-ja dënon pengimin e punës së ekipit të Nacionale-s në tubimin e Vetëvendosjes në Malishevë (25 January 2025); AGK-ja dënon kërcënimet ndaj ekipit të T7 në Pejë (19 February 2025)*.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. (2025i). *AGK-ja dhe RRGK dënojnë gjuhën seksiste ndaj gazetarëve nga kryetari Përparim Rama dhe këshilltari i tij (25 May 2025; 02 August 2025)*.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. (2025j). *AGK-ja dënon presionet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve të Kossev dhe Dragana Vukosavljević* (18 March 2025; 01 October 2025).

Fokus grup me qytetarë të moshës 18 deri 35 vjeç, organizuar më 5 qershor 2025 në Prishtinë

Fokus grup me qytetarë të moshës 36 deri 65 vjeç, organizuar më 12 qershor 2025 në Prishtinë

Fokus grup me profesionistë të mediave, organizuar më 13 qershor 2025 në Prishtinë

Mehmeti, J. (2025). *The expanding media landscape, decline in journalists' safety and low media literacy – The future of media in Kosovo: Facts and trends*. South East European Network for Professionalization of Media (SEENPM). https://futureofmedia.seenpm.org/wp-content/uploads/2025/02/Ourmedia_KS-ENG_25-01-22.pdf

Këshilli i Mediave të Shkruara. (2025a). *Vendime mbi ankesa (Janar–Shtator 2025)*. Prishtinë: KMSHK. https://presscouncil-ks.org/?page_id=11

Këshilli i Mediave të Shkruara. (2025b). *Kodi i mediave të shkruara të Kosovës*. Prishtinë: KMSHK. <https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fpresscouncil-ks.org%2Fwp-content%2Fuploads%2F2025%2F05%2FKodi-Shqip.docx&wdOrigin=BROWSELINK>

Regional Cooperation Council. (2024). *Balkan Barometer 2024: Public opinion survey*. Sarajevo: RCC. <https://www.rcc.int/balkanbarometer>

Reporters Without Borders. (2025). *2025 World Press Freedom Index: Kosovo country profile*. Paris: RSF. <https://rsf.org/en/country/kosovo>

Shtojca 1 – Përshkrimi i fokus grupeve

Fokus Group 1

Data: 5 Qershor 2025

Lokacioni: Prishtina

Pjesëmarrësit: Qytetarët (18–35)

1. Grua, 19, Prishtinë
2. Grua, 21, Fushë Kosovë
3. Burrë, 23, Prizren
4. Grua, 25, Podujeva
5. Grua, 27, Ferizaj
6. Grua, 28, Gjiilan
7. Grua, 30, Lipjan
8. Burrë, 20, Prishtinë
9. Burrë, 22, Peja
10. Grua, 32, Prishtinë

Fokus Group 2

Data: 12 Qershor 2025

Lokacioni:: Prishtina

Pjesëmarrësit: Qytetarët (36–65)

1. Grua, 38, Prishtinë
2. Grua, 42, Ferizaj
3. Grua, 45, Malishevë
4. Grua, 53, Pejë
5. Burrë, 39, Deçan
6. Burrë, 39, Podujevë
7. Burrë, 44, Gjakovë
8. Grua, 36, Prishtinë
9. Burrë, 41, Prizren
10. Grua, 45, Mitrovicë

Focus Group 3

Data: 13 Qershor 2025

Lokacioni: Prishtina

Pjesëmarrësit: Profesionistët medialë

1. Brikenda Rexhepi, Kryeredaktore, *Koha*
2. Arsim Lani, Redaktor i lajmeve, *TV 7*
3. Muhamet Hajrullahu, Kryeredaktor, *Telegrafi*
4. Agon Sinanaj, Redaktor, *Buletini Ekonomik*
5. Gentianë Pacarizi, Redaktor Menaxhues, *Kosovo 2.0*
6. Visar Duriqi, Gazetar, *Insajderi*
7. Mentor Gjergjaj, Kryeredaktor, *Reporteri*
8. Imer Mushkolaj, *Këshilli i Mediave të Shkruara*

PËR AUTORIN

Jeton Mehmeti është hulumtues dhe ligjërues i specializuar në politikat e mediave. Studimet themelore i kreu në Universitetin Ndërkombëtar të Malajzisë në Kuala Lumpur, studimet master në Universitetin e Evropës Qendrore në Vjenë ndërsa aktualisht ndjek studimet e doktoraturës në Universitetin e Grazit në Austri. Nga viti 2010 deri në vitin 2022, ai kontriboi në raportet vjetore të IREX-it si autor vendor për Indeksin e Qëndrueshmërisë së Mediave dhe Barometrin Vibrant të Informacionit. Hulumtimet e tij përqendrohen në rregullimin e mediave, gjuhën e urrejtjes dhe dezinformimin. Mehmeti është ligjërues në Universitetin Amerikan në Kosovë (RIT) dhe ka shërbyer si Zëvendëskryetar i Rrjetit të Rregullatore të Shteteve të Mesdheut (MNRA) dhe Kryetar i Komisionit të Pavarur të Mediave të Kosovës.

GAZETARIA NËN PRESION EKONOMIK, POLITIK DHE DIGJITAL

E ardhmja e medias në Kosovë – Shqyrtimi i aktorëve kyçë

Ky publikim është rezultat i hulumtimit të ndërmarrë si pjesë e projektit **“Media jonë: Veprim i shoqërisë civile për të gjeneruar edukim medial dhe aktivizëm, për të luftuar polarizimin dhe për të promovuar dialogun”**. Seria e dytë e hulumtimit u zhvillua në vitin 2025 brenda kornizës tematike “E ardhmja e mediave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi” dhe u përqendrua në analizimin e pikëpamjeve dhe opinioneve të profesionistëve të mediave lidhur me situatën aktuale dhe trendeve mbi mediat dhe demokracinë në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Turqi.

Projekti **“Media jonë: Veprim i shoqërisë civile për të gjeneruar edukim medial dhe aktivizëm, për të luftuar polarizimin dhe për të promovuar dialogun”** zbatohet bashkërisht nga nëntë organizata për zhvillimin e mediave nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Koordinator i projektit trevjeçar është Fondacioni Mediacentar Sarajevë. Partnerë në projekt janë Instituti Shqiptar i Medias në Tiranë; Bianet në Stamboll; Instituti Maqedonas për Media në Shkup; Instituti i Malit të Zi për Media në Podgoricë; Shkolla e Gazetarisë në Novi Sad; Instituti i Paqes në Lubjanë; Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në Prishtinë; dhe Rrjeti i Evropës Juglindore për Profesionalizimin e Medias (SEENPM).